



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.174

21 nëntor

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 013 datë 6.11.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve për ish-Jugosllavinë” 8541
Ligj nr.10 014 datë 6.11.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Islandës për lehtësimin e lëshimit të vizave”..... 8545
Ligj nr.10 015 datë 6.11.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Islandës për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar” 8551
Udhëzim i MF nr.26/1, datë 20.11.2008	Për një ndryshim në udhëzimin nr.26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare” 8564
Udhëzim i MF, MB dhe MPJ nr.38, datë 21.11.2008	Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo të ambasadave tona jashtë vendit dhe tarifa për lëshimin e pasaportave të udhëtimit..... 8568

LIGJ
Nr.10 013, datë 6.11.2008

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZBATIMIN E VENDIMEVE TË GJYKATËS
NDËRKOMBËTARE TË KRIMEVE PËR ISH-JUGOSLLAVINË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve për ish-Jugosllavinë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5933, datë 14.11.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZBATIMIN E DËNIMEVE TË GJYKATËS
NDËRKOMBËTARE TË KRIMEVE PËR ISH-JUGOSLLAVINË

Republika e Shqipërisë (për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, në vijim i referuar si "Shteti i kërkuar") dhe Kombet e Bashkuara, duke vepruar nëpërmjet Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve për ish-Jugosllavinë (në vijim referuar si "Gjykata Ndërkombëtare"),

duke kujtuar nenin 27 të statutit të Gjykatës Ndërkombëtare, të miratuar nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 827 (1993), të datës 25 maj 1993, sipas së cilës vuajtja e dënimit me burg do të kryhet në shtetin e përcaktuar nga Gjykata Ndërkombëtare nga një listë shtetesh, të cilat i kanë shprehur Këshillit të Sigurimit vullnetin e tyre për t'i pranuar personat e dënuar;

duke vërejtur vullnetin e shtetit të kërkuar për të zbatuar dënimet e dhëna nga Gjykata Ndërkombëtare;

duke kujtuar dispozitat e rregullave standarde minimale për trajtimin e të burgosurve, të miratuara nga rezolutat e ECOSOC 663 C(XXIV) të 31 të korrikut 1957 dhe 2067 (LXII) të 13 majit 1977, grupin e parimeve për mbrojtjen e të gjithë personave nën çfarëdo forme të ndalimit apo burgosjes, të miratuar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 43/173 të 9 dhjetorit 1988, dhe parimet bazë për trajtimin e të burgosurve, të miratuar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 45/111 të 14 dhjetorit 1990;

në mënyrë që t'u jepet fuqi vendimeve dhe dënimeve të Gjykatës Ndërkombëtare, kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1

Qëllimi dhe objekti i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje do të rregullojë çështjet që lidhen apo lindin nga të gjitha kërkesat, që i drejtohen shtetit, të cilit i bëhet kërkesa, për të zbatuar vendimet e dhëna nga Gjykata Ndërkombëtare.

Neni 2 **Procedura**

1. Kërkesa për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë për të zbatuar një dënim do të bëhet nga regjistruesi i Gjykatës Ndërkombëtare (në vijim i referuar si “Regjistruesi”), me miratimin e kryetarit të Gjykatës Ndërkombëtare.

2. Kur bën kërkesën, regjistruesi do t’ia paraqesë dokumentet e mëposhtme shtetit, të cilit i bëhet kërkesa:

- a) një kopje të vërtetuar të vendimit të formës së prerë;
- b) një deklaratë që tregon se deri në ç’masë është kryer dënimi, duke përfshirë informacion për ndonjë ndalim para gjyqit;
- c) sipas rastit, ndonjë raport mjekësor apo psikologjik për personin e dënuar, ndonjë rekomandim për trajtimin e tij/saj të mëtijshëm në shtetin e kërkuar dhe çdo faktor tjetër përkatës për zbatimin e dënimit.

3. Shteti, të cilit i bëhet kërkesa do t’ua paraqesë kërkesën autoriteteve kombëtare kompetente, në përputhje me ligjin kombëtar të shtetit, të cilit i bëhet kërkesa.

4. Autoritetet kombëtare kompetente të shtetit, të cilit i bëhet kërkesa do të vendosin menjëherë sipas kërkesës së regjistruesit, në përputhje me ligjin kombëtar.

Neni 3 **Zbatimi**

1. Për zbatimin e dënimit të shpallur nga Gjykata Ndërkombëtare, autoritetet kombëtare kompetente të shtetit, të cilit i bëhet kërkesa, do të kenë detyrim ligjor gjatë kohëzgjatjes së dënimit.

2. Kushtet e burgosjes do të rregullohen prej ligjit të shtetit, të cilit i bëhet kërkesa, duke iu nënshtuar mbikëqyrjes së Gjykatës Ndërkombëtare, siç parashikohet në nenet 6 deri në 8 dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 9 më poshtë.

3. Nëse, sipas ligjit kombëtar të zbatueshëm të shtetit, të cilit i bëhet kërkesa, personi i dënuar përfiton lirim para kohe, shteti, të cilit i bëhet kërkesa, do të njoftojë regjistruesin në lidhje me këtë fakt.

4. Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare do të vendosë, në konsultim me gjyqtarët e Gjykatës Ndërkombëtare, nëse është i përshtatshëm ndonjë lirim para kohe. Regjistruesi do të informojë shtetin, të cilit i bëhet kërkesa, për vendimin e kryetarit. Nëse kryetari vendos që lirimi para kohe nuk është i përshtatshëm, shteti, të cilit i bëhet kërkesa, do të veprojë në përputhje me të.

5. Kushtet e burgosjes do të jenë të pajtueshme me rregullat standarde minimale për trajtimin e të burgosurve, grupin e parimeve për mbrojtjen e të gjithë personave nën çfarëdo forme të ndalimit apo burgosjes dhe parimet bazë për trajtimin e të burgosurve.

Neni 4 **Transferimi i personit të dënuar**

Regjistruesi do të marrë masat e duhura për transferimin e personit të dënuar nga Gjykata Ndërkombëtare tek autoritetet kompetente të shtetit, të cilit i bëhet kërkesa dhe do t’i japë shtetit, të cilit i bëhet kërkesa një deklaram të përditësuar, që të tregojë se deri në ç’masë është kryer prej dënimit. Para transferimit të tij/saj, personi i dënuar do të informohet nga regjistruesi për përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5 **Non-bis-in-idem**

Personi i dënuar nuk do të gjykohej para një gjykate të shtetit, të cilit i bëhet kërkesa për veprat që përbëjnë shkelje serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar sipas statutit të Gjykatës Ndërkombëtare, për të

cilën ai është gjykuar tashmë nga Gjykata Ndërkombëtare.

Neni 6 **Inspektimi**

1. Autoritetet kompetente të shtetit, të cilit i bëhet kërkesa, do të lejojnë inspektimin e kushteve të ndalimit dhe trajtimit të të burgosurit(ve) nga ana e Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimin Çnjerëzor apo Degradues (në vijim referuar si "CPT") në çdo kohë dhe në mënyrë periodike. Shpeshësia e vizitave do të përcaktohet nga CPT. CPT-ja do t'i paraqesë një raport konfidencial shtetit, të cilit i bëhet kërkesa, bazuar në përfundimet e këtyre inspektimeve, i cili do t'i përgjigjet për t'ia kaluar atë kryetarit të Gjykatës Ndërkombëtare.

2. Shteti, të cilit i bëhet kërkesa, dhe kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare do të konsultohen me njëri-tjetrin për përfundimet e raporteve të referuara në paragrafin 1. Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare mund t'i kërkojë pas kësaj shtetit, të cilit i bëhet kërkesa, që t'i raportojë atij/asaj për ndryshimet në kushtet e ndalimit të sugjeruara nga CPT.

Neni 7 **Informacioni**

1. Shteti, të cilit i bëhet kërkesa, do të njoftojë regjistruesin menjëherë:

- a) dy muaj para plotësimit të dënimit;
- b) nëse personi i dënuar është arratisur nga ndalimi, para se të plotësonte dënimin;
- c) nëse personi i dënuar ka vdekur.

2. Pavarësisht nga paragrafi i mëparshëm, regjistruesi dhe shteti, të cilit i bëhet kërkesa, do të konsultohen me njëri-tjetrin për të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin e vendimit, me kërkesën e secilës palë.

Neni 8 **Falja dhe ulja e masës së dënimit**

1. Nëse, sipas ligjit kombëtar të zbatueshëm të shtetit, të cilit i bëhet kërkesa, personi i dënuar përfiton falje ose ulje të masës së dënimit, shteti, të cilit i bëhet kërkesa, do ta njoftojë regjistruesin në lidhje me të.

2. Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare do të përcaktojë, në konsultim me gjyqtarët e Gjykatës Ndërkombëtare, nëse falja ose ulja e masës së dënimit është e përshtatshme. Regjistruesi do ta informojë shtetin, të cilit i bëhet kërkesa, për vendimin e kryetarit. Nëse kryetari vendos që falja ose ulja e masës së dënimit nuk është e përshtatshme, shteti, të cilit i bëhet kërkesa, do të veprojë në përputhje me të.

Neni 9 **Ndërprerja e zbatimit**

1. Zbatimi i një vendimi do të ndërpritet kur:

- a) dënimi është kryer;
- b) kur i dënuari ka vdekur;
- c) kur ka një falje për të dënuarin;
- d) pas një vendimi të Gjykatës Ndërkombëtare, siç përmendet në paragrafin 2.

2. Gjykata Ndërkombëtare mund të vendosë në çdo kohë që t'i kërkojë shtetit, të cilit i bëhet kërkesa, ndërprerjen e zbatimit dhe transferimin e personit të dënuar në një shtet tjetër ose në Gjykatën Ndërkombëtare.

3. Autoritetet kompetente të shtetit, të cilit i bëhet kërkesa, do ta ndërpresin zbatimin e dënimit sapo të njoftohet nga regjistruesi për ndonjë vendim apo masë, si rezultat i të cilës dënimi pushon së qeni i zbatueshëm.

Neni 10 **Pamundësia për të zbatuar dënimin**

Nëse, në çfarëdo kohe pas marrjes së vendimit për të zbatuar dënimin, për ndonjë arsye ligjore apo praktike, zbatimi i mëtejshëm është bërë i pamundur, shteti i kërkuar do të informojë menjëherë regjistruesin. Regjistruesi do të bëjë rregullimet e duhura për transferimin e personit të dënuar. Autoritetet kompetente të shtetit, të cilit i bëhet kërkesa, do të kenë parasysh kalimin e të paktën 60 ditëve nga njoftimi i regjistruesit para se të marrin masa të tjera për çështjen.

Neni 11
Shpenzimet

Gjykata Ndërkombëtare do të përgjigjet për shpenzimet që lidhen me transferimin e personit të dënuar për në shtetin e kërkuar dhe prej tij, me përjashtim të rastit kur palët bien dakord ndryshe. Shteti i kërkuar do t'i paguajë të gjitha shpenzimet e tjera të shkaktuara prej zbatimit të dënimit.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me marrjen nga Gjykata Ndërkombëtare të njoftimit me shkrim të shtetit, të cilit i bëhet kërkesa, që ka përmbushur kërkesat e domosdoshme ligjore kombëtare.

Neni 13
Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për sa kohë që vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare do të zbatohen nga shteti, të cilit i bëhet kërkesa, sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

Duke u konsultuar, secila palë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje, duke njoftuar dy muaj përpara. Kjo Marrëveshje nuk do të ndërpritet para se të plotësohen apo ndërpriten dënimet, për të cilat zbatohet kjo Marrëveshje, dhe, nëse do të aplikohet, para kryerjes së transferimit të të dënuarit siç parashikohet në nenin 10.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, të autorizuar në mënyrë të rregullt, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në.....më.....2008, në dy kopje në gjuhën angleze.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

PËR KOMBET E BASHKUARA
Sekretari
Gjykata Ndërkombëtare e Krimeve për ish-Jugosllavinë

LIGJ
Nr.10 014, datë 6.11.2008

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
ISLANDËS PËR LEHTËSIMIN E LËSHIMIT TË VIZAVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Islandës për lehtësimin e lëshimit të vizave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5934, datë 14.11.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE

NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ISLANDËS PËR LEHTËSIMIN E LËSHIMIT TË VIZAVE

Palët: Republika e Shqipërisë dhe Islanda,

duke dëshiruar, si një hap i parë konkret drejt regjimit të udhëtimit pa viza, për të lehtësuar kontaktet midis njerëzve si një kusht i rëndësishëm për zhvillimin konstant të lidhjeve ekonomike humanitare, kulturore, shkencore dhe të tjera, duke lehtësuar lëshimin e vizave për qytetarët e Republikës së Shqipërisë;

duke konsideruar marrëdhëniet e ngushta midis Komunitetit Europian dhe Islandës, veçanërisht me anë të marrëveshjes së përfunduar më 18 maj 1999 nga Këshilli i Bashkimit Europian dhe Republikës së Islandës dhe Mbretërisë së Norvegjisë që lidhet me asocimin e këtyre dy shteteve me implementimin, aplikimin e zhvillimin e *Schengen Acquis*;

duke pasur parasysh marrëveshjen midis Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë së 18 shtatorit 2007 për lehtësimin e lëshimit të vizave për qytetarët e Bashkimit Europian dhe Republikës së Shqipërisë;

duke iu referuar Deklaratës së Përbashkët për atë marrëveshje në lidhje me Islandën dhe Mbretërinë e Norvegjisë;

duke pasur parasysh se qytetarët islandezë përjashtohen nga kërkesa për vizë, kur udhëtojnë për në Republikën e Shqipërisë për një periudhë kohe që nuk i kalon 90 ditë, për periudhën e 180 ditëve ose kur janë transit nëpërmjet territorit të Shqipërisë,

duke njohur se në qoftë se Republika e Shqipërisë të paraqiste kërkesën për vizë për qytetarët islandezë, të njëjtat lehtësira të dhëna sipas kësaj Marrëveshjeje për qytetarët e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë automatike, mbi bazën e reciprocitetit, do të aplikoheshin dhe për qytetarët islandezë, duke njohur se lehtësimi i vizave nuk duhet të çojë në migracionin e paligjshëm dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë sigurisë dhe ripranimit;

duke pasur parasysh marrëveshjet midis Islandës dhe Mbretërisë së Danimarkës dhe midis Islandës dhe Republikës së Finlandës për lëshimin e vizave në emër të Islandës;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që të lehtësojë lëshimin e vizave për një qëndrim që synon që të jetë 90 ditë për periudhën e 180 ditëve për shtetasit e Republikës së Shqipërisë.

2. Në qoftë se Republika e Shqipërisë do të paraqiste kërkesën për vizë për qytetarët e Islandës, të njëjtat lehtësira të dhëna sipas kësaj Marrëveshjeje për qytetarët e Republikës së Shqipërisë automatikisht, në bazë të reciprocitetit do të zbatoheshin dhe për qytetarët e Islandës.

Neni 2

Dispozita të përgjithshme

1. Lehtësimi i vizave, i parashikuar në këtë Marrëveshje, do të zbatohet për qytetarët e Republikës së Shqipërisë vetëm për sa kohë që ata nuk janë të përjashtuar nga kërkesa për vizë sipas ligjeve dhe rregulloreve të Islandës, nga kjo Marrëveshje ose marrëveshje të tjera ndërkombëtare.

2. Ligji i brendshëm i Republikës së Shqipërisë ose i Islandës do të zbatohet për çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, të tilla si refuzimi për dhënien e vizës, njohja e dokumenteve të udhëtimit, vërtetimi i mjeteve të mjaftueshme të jetesës dhe refuzimi i hyrjes dhe masat e dëbimit.

Neni 3 Përkufizime

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje:

a) “Qytetar i Islandës” do të thotë një person që posedon ose ka shtetësinë e fituar të Islandës në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar;

b) “Qytetar i Republikës së Shqipërisë” do të thotë një person që posedon ose ka shtetësinë e fituar të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar;

c) “Vizë” do të thotë një autorizim i lëshuar ose i marrë nga Islanda, i cili kërkohet me synimin për:

- hyrje në Islandë, me synimin për të qëndruar jo më tepër se 90 ditë gjithsej;

- hyrje për transit përmes territorit të Islandës;

d) “Person me banim të ligjshëm” do të thotë një qytetar i Republikës së Shqipërisë i autorizuar ose që ka të drejtën të qëndrojë më tepër se 90 ditë në territorin e Islandës, mbi bazën e legjislacionit kombëtar;

e) “Shtet anëtar i Shengenit” do të thotë çdo shtet që zbaton *acquis* e Shengenit krejtësisht brenda kuptimit të marrëveshjes së përfunduar më 18 maj 1999 nga Këshilli i Bashkimit Europian dhe Republikës së Islandës dhe Mbretërisë së Norvegjisë që lidhet me asocimin e këtyre dy shteteve me implementimin, aplikimin e zhvillimin të *Schengen Acquis*.

Neni 4 Provat shkresore në lidhje me qëllimin e udhëtimit

1. Për kategoritë e mëposhtme të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, dokumentet e mëposhtme janë të mjaftueshme për të justifikuar qëllimin e udhëtimit në palën tjetër:

a) për anëtarët e delegacioneve zyrtare, të cilët, pas një ftese zyrtare që i drejtohet Republikës së Shqipërisë, do të marrin pjesë në mbledhje, konsultime, negociata ose programe shkëmbimi, si dhe në ngjarjet e organizuara në territorin e Islandës nga organizata ndërqeveritare:

- një letër e lëshuar nga autoriteti shqiptar që konfirmon se kërkuesi është anëtar i delegacionit shqiptar që udhëton për në territorin e Islandës për të marrë pjesë në ngjarjet e sipërpërmendura, e shoqëruar me një kopje të ftesës zyrtare;

b) për njerëzit e biznesit dhe përfaqësuesit e organizatave të biznesit:

- një kërkesë e shkruar nga një person juridik ose shoqëri, organizatë apo një zyrë ose degë e këtij personi juridik apo shoqërie pritëse, shteti apo autoritetet vendore të Islandës, apo komitetet organizuese të ekspozitave tregtare dhe industriale, konferencave dhe simpoziumeve të mbajtuara në territorin e Islandës, të kundërfirmosur nga Dhoma e Tregtisë e Republikës së Shqipërisë;

c) për gazetarët:

- një certifikatë apo dokument tjetër i lëshuar nga një organizatë profesionale që provon që personi në fjalë është një gazetar i kualifikuar dhe një dokument i lëshuar prej punëdhënësit të tij/saj që deklaron se qëllimi i udhëtimit është të kryejë punën e gazetarit;

d) për personat që marrin pjesë në aktivitete shkencore, kulturore dhe artistike, duke përfshirë universitetin dhe programet e tjera të shkëmbimit:

- një kërkesë e shkruar prej organizatës pritëse për të marrë pjesë në këto aktivitete;

e) për nxënësit, studentët, studentët e diplomuar dhe mësuesit shoqëruar, të cilët ndërmarrin udhëtime për qëllime studimi ose trajnimi arsimor, duke përfshirë edhe kuadrin e programeve të shkëmbimit, si dhe aktiviteteve të tjera që lidhen me shkollën:

- një kërkesë me shkrim apo një vërtetim të regjistrimit nga universiteti, akademja, instituti, kolegji ose shkolla pritëse apo kartat e studentit ose certifikatat e kurseve që do të ndiqen;

f) për pjesëmarrësit në ngjarjet ndërkombëtare sportive dhe personat që i shoqërojnë ata në cilësinë profesionale:

- një kërkesë me shkrim prej organizatës pritëse: autoritetet kompetente, federatat kombëtare

sportive ose Komiteti Olimpik Kombëtar i Islandës;

g) për pjesëmarrësit në programet e shkëmbimit zyrtar organizuar nga qytetet e binjakëzuara;

- një kërkesë me shkrim e kreut të administratës/kryetar i bashkisë të këtyre qyteteve;

h) për të afërmit – bashkëshorti, fëmijët (duke përfshirë të birësuarit) prindërit (duke përfshirë kujdestarët) gjyshërit, nipat dhe mbesat, që vizitojnë qytetarët shqiptarë që banojnë ligjërisht në territorin e Islandës:

- një kërkesë me shkrim prej personit pritës;

i) për arsye vizite në një varrim ushtarak dhe civil;

- një dokument zyrtar që konfirmon ekzistencën dhe ruajtjen e varrit, si dhe marrëdhëniet familjare apo të tjera midis kërkuesit dhe të varrosurit;

j) për shoferët që drejtojnë shërbime të ngarkesave ndërkombëtare dhe të transportit të pasagjerëve midis territorit të Republikës së Shqipërisë dhe vendeve anëtare të BE-së në automjetet e regjistruara në BE apo në Republikën e Shqipërisë:

- një kërkesë me shkrim nga shoqata kombëtare (unioni) i transportuesve të Republikës së Shqipërisë që parashikon transportimin kombëtar rrugor, që deklaron qëllimin, kohëzgjatjen dhe shpeshtësinë e udhëtimeve;

k) për personat që udhëtojnë për turizëm:

- një certifikatë ose vërtetim nga një agjenci udhëtimi apo një operatori udhëtimesh të akredituar nga Islanda në kuadrin e bashkëpunimit vendor konsullor që konfirmon rezervimin e një udhëtimi të organizuar.

2. Kërkesa me shkrim, e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, do të përmbajë zërat e mëposhtëm:

a) për personat e ftuar – emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, seksin, shtetësinë, numrin e dokumentit të identitetit, kohën dhe qëllimin e udhëtimit, numrin e hyrjeve dhe, kur duhet, emrin e bashkëshortit dhe fëmijët që e shoqërojnë personin e ftuar;

b) për personin e ftuar, emrin, mbiemrin dhe adresën;

c) për personin juridik, shoqërinë ose organizatën e ftuar – emrin e plotë me adresën dhe:

- në qoftë se kërkesa lëshohet nga një organizatë, emri dhe pozicioni i personit që shkruan kërkesën,

- në qoftë se personi ftues është një person juridik apo shoqëri, apo një zyrë, apo një degë e një personi të tillë juridik, apo një shoqërie e krijuar në territorin e Islandës, numri i regjistrimit siç kërkohet nga ligji kombëtar i Islandës.

3. Për kategoritë e personave të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha kategoritë e vizave do të lëshohen në përputhje me procedurat e thjeshtësuara pa kërkuar ndonjë justifikim tjetër, ftesë apo vërtetim në lidhje me qëllimin e udhëtimit, që parashikohet nga legjislacioni i Islandës.

Neni 5

Lëshimi i vizave me shumë hyrje

1. Misionet diplomatike dhe zyrat konsullore të Islandës do të lëshojnë viza me shumë kalime me një afat vlefshmërie deri në 5 vjet për kategoritë e mëposhtme të personave:

a) anëtarët e Këshillit të Ministrave, të Parlamentit, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, në qoftë se ata nuk përjashtohen nga kërkesa për vizë me anë të kësaj Marrëveshjeje, në ushtrimin e detyrave të tyre, me një afat vlefshmërie të kufizuar deri në kohëzgjatjen e detyrës së tyre, në qoftë se kjo është më pak se 5 vjet;

b) bashkëshortët dhe fëmijët (duke përfshirë të birësuarit), të cilët janë nën moshën 21 vjeç ose janë të varur, që vizitojnë qytetarët shqiptarë që jetojnë ligjërisht në territorin e Islandës me afat vlefshmërie të kufizuar sa kohëzgjatja e vlefshmërisë së autorizimit të tyre për banimin ligjor.

2. Misionet diplomatike dhe zyrat konsullore të Islandës do të lëshojnë viza me shumë kalime me afat vlefshmërie deri në një vit për kategoritë e mëposhtme të personave, me kushtin që gjatë vitit të mëparshëm ata të kenë marrë të paktën një vizë, ta kenë përdorur atë në përputhje me ligjet për hyrjen dhe qëndrimin e shtetit të vizituar dhe që të ketë arsye për të kërkuar një vizë hyrjeje me shumë kalime:

a) anëtarët e delegacioneve zyrtare, të cilët, pas një ftese zyrtare drejtuar Republikës së Shqipërisë,

do të marrin pjesë rregullisht në mbledhje, konsultime, negociata ose programe shkëmbimesh, si dhe në ngjarje të mbajtura në territorin e Islandës nga organizatat ndërqeveritare;

b) njerëz të biznesit dhe përfaqësues të organizatave të biznesit, të cilët udhëtojnë rregullisht në Islandë;

c) personat që marrin pjesë në veprimtari shkencore, kulturore dhe artistike, duke përfshirë universitetin dhe programet e tjera të shkëmbimit, të cilët udhëtojnë rregullisht për në Islandë;

d) pjesëmarrësit në ngjarje ndërkombëtare sportive dhe personat që i shoqërojnë ata në cilësinë profesionale;

e) gazetarë;

f) pjesëmarrësit në programet zyrtare të shkëmbimit, organizuar nga qytetet e binjakëzuara;

g) shoferët që drejtojnë shërbime ndërkombëtare për transport ngarkesë dhe pasagjerësh midis territoreve të Republikës së Shqipërisë dhe vendeve anëtare të BE-së me automjetet e regjistruara në BE apo Republikën e Shqipërisë;

h) studentët e diplomuar, të cilët udhëtojnë rregullisht për qëllimet e studimit ose të trajnimit arsimor, duke përfshirë dhe kuadrin e programeve të shkëmbimit.

3. Misionet diplomatike dhe zyrat konsullore të Islandës do të lëshojnë viza me shumë kalime me afat vlefshmërie për një minimum prej dy vjetësh dhe një maksimum prej 5 vjetësh për kategoritë e personave që përmenden në pikën 2 të këtij neni, me kushtin që gjatë dy viteve të mëparshme ata t'i kenë përdorur vizat njëvjeçare me shumë kalime në përputhje me ligjet për hyrjen dhe qëndrimin në Islandë dhe që arsyet për të kërkuar një vizë hyrjeje me shumë kalime të jenë ende të vlefshme.

4. Periudha totale e qëndrimit të personave që përmendëm në paragrafët 1 deri në 3 nuk do t'i kalojnë 90 ditë për periudhën e 180 ditëve në territorin e Islandës dhe ndonjë vendi tjetër anëtar të Shengenit.

Neni 6

Pagesat për përpunimin e kërkesave për vizë

1. Paga për përpunimin e kërkesave për vizë për qytetarët e Republikës së Shqipërisë do të jetë 35 euro.

Shuma e lartpërmendur mund të rishikohet në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 13 (4).

Në qoftë se Republika e Shqipërisë do të riparaqiste kërkesën për vizë për qytetarët islandezë, pagesa për vizë që do të vihej nga Republika e Shqipërisë nuk do të ishte më e lartë se 35 euro apo shuma e rënë dakord, në qoftë se pagesa do të rishikohet në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 13 (4).

2. Pagesat për përpunimin e kërkesave për vizë përjashtohen për kategoritë e mëposhtme të personave:

a) të afërmit-bashkëshorti, fëmijët (duke përfshirë të birësuarit), prindërit (duke përfshirë kujdestarët), gjyshërit, nipat dhe mbesat, që vizitojnë qytetarët shqiptarë që banojnë ligjërisht në territorin e Islandës;

b) për anëtarët e delegacioneve zyrtare, të cilët, pas një ftese zyrtare që i drejtohet Republikës së Shqipërisë, do të marrin pjesë në mbledhje, konsultime, negociata ose programe shkëmbimi, si dhe në ngjarjet e organizuara në territorin e Islandës nga organizatat ndërqeveritare;

c) anëtarët e Këshillit të Ministrave, të Parlamentit, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, në qoftë se ata nuk përjashtohen nga kërkesa për vizë me anë të kësaj Marrëveshjeje;

d) nxënësit, studentët, studentët e diplomuar dhe mësuesit shoqëruar, të cilët ndërmarrin udhëtime për qëllime studimi ose trajnimi arsimor;

e) personat me aftësi të kufizuar dhe personi që i shoqëron ata, në qoftë se është e domosdoshme;

f) personat që kanë paraqitur dokumentet që vërtetojnë domosdoshmërinë e udhëtimit të tyre për arsye humanitare, duke përfshirë marrjen e trajtimit mjekësor urgjent dhe personi që i shoqëron një të tillë, ose për të marrë pjesë në funeralin e një të afërmi ose për të vizituar një të afërm që është sëmurë rëndë;

g) pjesëmarrësit në ngjarje sportive ndërkombëtare dhe personat që i shoqërojnë ata në cilësinë profesionale;

h) personat që marrin pjesë në veprimtari shkencore, kulturore dhe artistike, duke përfshirë universitetin dhe programe të tjera të shkëmbimit;

i) pjesëmarrës në programet zyrtare të shkëmbimit, organizuar nga qytetet e binjakëzuara.

Neni 7

Kohëzgjatja e procedurave për përpunimin e kërkesave për vizë

1. Misionet diplomatike dhe zyrat konsullore të Islandës do të marrin një vendim për kërkesën për të lëshuar një vizë brenda dhjetë ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës dhe dokumenteve të kërkuara për lëshimin e vizës.

2. Periudha kohore për marrjen e një vendimi për kërkesën për vizë mund të shtyhet deri në tridhjetë ditë kalendarike në raste individuale, përkatësisht kur nevojitet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës.

3. Periudha kohore për marrjen e një vendimi për kërkesën për vizë mund të reduktohet në 3 ditë pune ose më pak në rastet urgjente.

Neni 8

Nisja në rastin e dokumenteve të humbura ose të vjedhura

Qytetarët e Islandës dhe të Republikës së Shqipërisë, që kanë humbur dokumentet e tyre të identitetit ose të cilëve u janë vjedhur këto dokumente, ndërsa qëndronin në territorin e Republikës së Shqipërisë ose Islandës, mund të largohen nga ky territor me arsyen e dokumenteve të vlefshme të identitetit që u japin të drejtën ta kalojnë kufirin, të lëshuara nga misione diplomatike ose zyrat konsullore të Islandës ose Shqipërisë pa vizë ose ndonjë autorizim tjetër.

Neni 9

Shtyrja e vizës në rrethana përjashtimore

Qytetarët e Republikës së Shqipërisë, të cilët nuk e kanë mundësinë të largohen nga territori i Islandës në kohën e deklaruar në vizat e tyre për arsye të forcës madhore, do të kenë një zgjatje të afatit të tyre të vizës falas, në përputhje me legjislacionin të zbatuar nga Islanda për periudhën që kërkohet për kthimin e tyre në shtetin e banimit të tyre.

Neni 10

Pasaportat diplomatike

1. Qytetarët e Republikës së Shqipërisë, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, mund të hyjnë, të largohen dhe të tranzitojnë nëpër territoret e Islandës pa viza.

2. Periudha totale e qëndrimit të qytetarëve të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk do t'i kalojë 90 ditë për periudhën prej 180 ditësh në territorin e Islandës ose të ndonjë vendi tjetër, anëtar të Shengenit.

Neni 11

Baza e barabartë e udhëtimit

Duke iu nënshtruar rregullave dhe rregulloreve kombëtare në lidhje me sigurinë kombëtare të Islandës, qytetarët e Republikës së Shqipërisë do të kenë të drejtë të udhëtojnë brenda territorit të Islandës në mënyrë të barabartë me qytetarët islandezë.

Neni 12

Konsultimet e përbashkëta

Konsultimet e përbashkëta do të mbahen kurdoherë që është e nevojshme me kërkesën e njëres prej palëve për të diskutuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje do të ratifikohet ose miratohet nga palët në përputhje me procedurat e tyre përkatëse dhe do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës në të cilën palët do të njoftojnë njëra-tjetrën se procedurat që përmendëm më sipër janë plotësuar.

2. Në lidhje me devijimin nga paragrafi 1 i këtij neni, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes midis Islandës dhe Republikës së Shqipërisë për ripranimin e personave, në

qoftë se kjo datë është pas datës së parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Kjo Marrëveshje nënshkruhet për një periudhë kohore të përcaktuar, me përjashtim të rastit kur ndërpritet në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni.

4. Kjo Marrëveshje mund të amendohet me marrëveshje me shkrim të palëve. Amendamentet do të hyjnë në fuqi, pasi palët të kenë njoftuar njëra-tjetrën për plotësimin e procedurave të tyre të brendshme të nevojshme për këtë qëllim.

5. Çdo palë mund ta pezullojë tërësisht ose pjesërisht këtë Marrëveshje, për arsye të rendit publik, të mbrojtjes së sigurisë kombëtare ose mbrojtjes së shëndetit publik. Vendimi për pezullimin do t'i njoftohet palës tjetër jo më vonë se 48 orë para hyrjes së tij në fuqi. Pala që e ka pezulluar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do ta informojë palën tjetër kur arsyet për pezullimin e saj nuk zbatohen më.

6. Secila palë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje duke njoftuar me shkrim palën tjetër. Kjo Marrëveshje nuk do të jetë më në fuqi 90 ditë pas datës së këtij njoftimi.

Bërë në Tiranë, më 26 gusht 2008, në dy kopje në gjuhët shqip, islandisht dhe anglisht, ku secili tekst është njëlloj autentik. Në rast keqinterpretimesh teksti në anglisht do të ketë përparësi.

LIGJ

Nr.10 015, datë 6.11.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ISLANDËS, PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Islandës për ripranimin e personave me qëndrim të paaautorizuar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5935, datë 14.11.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ISLANDËS, PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE
ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR

Palët, Republika e Shqipërisë dhe Islanda,
të vendosura për të forcuar bashkëpunimin e tyre, me qëllim për të luftuar imigracionin e paligjshëm në mënyrë më efektive;

duke marrë në konsideratë marrëdhëniet e ngushta mes Komunitetit European dhe Islandës, veçanërisht pas marrëveshjes së përfunduar më 18 maj 1999 nga Këshilli i Bashkimit European dhe Republikës së Islandës dhe Mbretërisë së Norvegjisë, që lidhet me asocimin e këtyre dy shteteve me implementimin, aplikimin e zhvillimin e Schengen Acquis;

duke marrë parasysh marrëveshjen mes Komunitetit European dhe Republikës së Shqipërisë të 14 prillit 2005 për ripranimin;

referuar deklaratës së bashkëngjitur të asaj marrëveshjeje që lidhet me Islandën dhe Mbretërinë e Norvegjisë;

duke dëshiruar të përcaktojnë, me anë të kësaj Marrëveshjeje dhe mbi bazën e reciprocitetit, procedura të shpejta dhe të efektshme për identifikimin dhe kthimin e sigurt dhe të rregullt të personave të cilët nuk përmbushin, ose nuk i përmbushin më tej, kushtet për të hyrë, për të qëndruar ose për të banuar në territoret e Republikës së Shqipërisë ose të Islandës dhe për të lehtësuar kalimin transit të këtyre personave në një frymë bashkëpunimi;

duke theksuar që kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Republikës së Shqipërisë dhe Islandës që burojnë nga e drejta ndërkombëtare dhe në veçanti, nga konventa europiane e 4 nëntorit 1950 për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, nga konventa e 28 korrikut 1951 dhe protokollit i 31 janarit 1967 për statusin e refugjatëve, dhe nga instrumentet ndërkombëtare për ekstradimin,

kanë rënë dakord për sa vijon.

Neni 1
Përkufizime

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje:

a) “Ripranim” nënkupton transferimin nga shteti kërkues dhe pranim nga shteti i kërkuar të personave (qytetarë të shtetit të kërkuar ose qytetarë të vendeve të treta ose persona pa shtetësi), të cilët kanë hyrë, qëndrojnë ose banojnë në shtetin kërkues, në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

b) “Shtetas i Republikës së Shqipërisë” nënkupton çdo person që ka shtetësinë e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar.

c) “Shtetas i Islandës” nënkupton çdo person që ka shtetësinë islandeze, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar.

d) “Shtetas i një vendi të tretë” nënkupton çdo person që ka shtetësi të ndryshme nga ajo e Republikës së Shqipërisë ose Islandës.

e) “Person pa shtetësi” nënkupton çdo person që nuk ka shtetësi as të Republikës së Shqipërisë e as islandeze, për të cilin nuk ka prova që zotëron ndonjë shtetësi.

f) “Autorizim qëndrimi” nënkupton një leje të çdo lloji të lëshuar nga Republika e Shqipërisë ose nga Islanda, që i jep të drejtën një personi të qëndrojë në territorin e saj. Ky përkufizim nuk përfshin lejet e përkohshme për të qëndruar në territorin e saj, në lidhje me shqyrtimin e një aplikimi për azil ose të një aplikimi për lejeqëndrimi.

g) “Vizë” nënkupton një autorizim të lëshuar apo një vendim të marrë nga Shqipëria ose nga Islanda, i cili kërkohet për të hyrë ose për të kaluar transit në territorin e saj. Ky përkufizim nuk përfshin vizën e transitit aeroportual.

h) “Shteti kërkues” nënkupton shtetin (Republikën e Shqipërisë ose Islandën) që dorëzon një kërkesë ripranimi sipas nenit 7 ose një kërkesë transiti sipas nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

i) “Shteti që i kërkohet” nënkupton shtetin (Republikën e Shqipërisë ose Islandën) të cilit i drejtohet kërkesa e ripranimit, sipas nenit 7 ose një kërkesë transiti sipas nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

j) “Autoriteti kompetent” nënkupton çdo autoritet kombëtar të Republikës së Shqipërisë ose të Islandës, të cilit i është besuar zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me nenin 19 (1) paragrafi “a” i saj.

k) “Zonë kufitare” nënkupton territoret portuale detare dhe aeroportet ndërkombëtare, duke përfshirë zonat doganore të Islandës dhe Republikës së Shqipërisë.

l) “Pikë kalimi kufitare” nënkupton çdo pikë kalimi të autorizuar nga Islanda ose Republika e Shqipërisë për kalimin e kufijve të tyre respektivë, tokësorë ose detarë, duke përfshirë aeroportet e portet detare.

m) “Transit” nënkupton kalimin e një qytetari të një vendi të tretë ose të një personi pa kombësi përmes territorit të shtetit të kërkuar ndërsa udhëton nga shteti kërkues drejt vendit të destinacionit.

n) “Zona Schengen” nënkupton territorin e kombinuar të të gjitha shteteve aplikuese në *Schengen acquis* me të drejta të plota, duke nënkuptuar edhe marrëveshjen e përfunduar më 18 maj 1999 nga Këshilli i Bashkimit Europian dhe Republikës së Islandës dhe Mbretërisë së Norvegjisë që lidhet me asocimin e këtyre dy shteteve me implementimin, aplikimin e zhvillimin e *Schengen Acquis*.

PJESA I

DETYRIMET PËR RIPRANIM NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 2

Ripranimi i shtetasve të vet

1. Republika e Shqipërisë do të ripranojë, me kërkesën e Islandës dhe pa formalitete të tjera, përveç atyre të parashikuara në këtë Marrëveshje, të gjithë personat të cilët nuk plotësojnë, ose nuk plotësojnë më tej, kushtet në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e Islandës, me kusht që të provohet, ose të pranohet në mënyrë të vlefshme në bazë të sigurimit të provave të qarta, se ata janë shtetas të Republikës së Shqipërisë.

2. Republika e Shqipërisë gjithashtu do të ripranojë:

- fëmijë të mitur e të pamartuar të personave të përmendur në paragrafin 1, pavarësisht vendlindjes ose kombësisë, nëse nuk kanë lejeqëndrimi të pavarur në Islandë;

- bashkëshortët, mbajtës të një kombësie tjetër, të personave të përmendur në paragrafin 1, pasi pajisen me lejen për të hyrë e për të qëndruar, ose marrin lejen për të hyrë e për të qëndruar në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse nuk kanë lejeqëndrimi të pavarur në Islandë;

3. Republika e Shqipërisë do të ripranojë persona të cilëve u është hequr ose kanë hequr dorë nga nënshtetësia e Republikës së Shqipërisë që kur kanë hyrë në territorin e Islandës, nëse këtyre personave nuk u është premtuar të paktën natyralizimi nga Islanda.

4. Republika e Shqipërisë, sipas nevojës dhe pa vonesë, do të pajisë personin për ripranimin e të cilit është rënë dakord, me dokumente udhëtimi që kërkohen për kthimin e tij/saj të vlefshme për një periudhë 20-ditore. Nëse, për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar fillimisht, Republika e Shqipërisë, pa vonesë, do të shtyjë vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit ose, nëse është nevoja, do të lëshojë një dokument të ri udhëtimi me të njëjtën periudhë vlefshmërie.

Neni 3

Ripranimi i shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi

1. Republika e Shqipërisë do të ripranojë, me kërkesën e Islandës dhe pa formalitete të mëtejshme, veç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi të cilët nuk plotësojnë, ose nuk i plotësojnë më tej, kushtet në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e Islandës, me kusht që të provohet ose të pranohet në mënyrë të vlefshme në bazë të sigurimit të provave të qarta, se ata persona:

a) kanë, ose në kohën kur kanë hyrë, kishin vizë ose lejeqëndrimi të lëshuar nga Republika e Shqipërisë; ose

b) kanë hyrë në territorin e Islandës ose në zonën *Schengen*, pasi kanë qëndruar në, ose kanë kaluar transit nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Detyrimi për ripranim, i parashikuar në paragrafin 1, nuk do të zbatohet nëse:

a) shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi ka kaluar vetëm transit nëpër një aeroport ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë; ose

b) Islanda i ka lëshuar shtetasit të vendit të tretë ose personit pa shtetësi një vizë ose leje qëndrimi

para ose pas hyrjes në territorin e saj, përveç rastit kur

- ai person zotëron një vizë ose lejeqëndrimi, të lëshuar nga Republika e Shqipërisë, që ka një periudhë vlefshmërie më të gjatë; ose

- viza ose leja e qëndrimit të lëshuar nga Islanda është marrë duke përdorur dokumente të rreme apo të falsifikuara; ose

- personi nuk plotëson kushtet që i bashkëlidhen vizës.

3. Pasi Republika e Shqipërisë ka dhënë një përgjigje pozitive për aplikimin e ripranimit, Islanda do ta pajisë personin, për ripranimin e të cilit është rënë dakord, me dokumente udhëtimi të njohura nga Republika e Shqipërisë.

PJESA II

DETYRIMET PËR RIPRANIM NGA ISLANDA

Neni 4

Ripranimi i shtetasve islandezë

1. Islanda do të ripranojë, me kërkesën e Republikës së Shqipërisë dhe pa formalitete të tjera, përveç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë personat të cilët nuk plotësojnë, ose nuk i plotësojnë më tej, kushtet në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e Republikës së Shqipërisë, me kusht që të provohet ose të pranohet në mënyrë të vlefshme në bazë të sigurimit të provave të qarta se ata janë shtetas islandezë.

2. Islanda gjithashtu do të ripranojë:

- fëmijë të mitur e të pamartuar të personave të përmendur në paragrafin 1, pavarësisht vendlindjes ose kombësisë, nëse nuk kanë lejeqëndrimi të pavarur në Republikën e Shqipërisë;

- bashkëshortët, mbajtës të një kombësie tjetër, të personave të përmendur në paragrafin 1, pasi pajisen me lejen për të hyrë e për të qëndruar, ose marrin lejen për të hyrë e për të qëndruar në territorin e Islandës, nëse nuk kanë lejeqëndrimi të pavarur në Republikën e Shqipërisë.

3. Islanda do të ripranojë persona të cilëve u është hequr ose kanë hequr dorë nga nënshtetësia islandeze që kur kanë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse këtyre personave nuk i është premtuar të paktën natyralizimi nga Republika e Shqipërisë

4. Islanda, sipas nevojës dhe pa vonesë, do ta pajisë personin, për ripranimin e të cilit është rënë dakord, me dokumente udhëtimi që i kërkojnë për kthimin e tij/saj të vlefshme për një periudhë 20-ditore. Nëse, për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar fillimisht, Islanda, pa vonesë, do të shtyjë vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit ose, nëse është nevoja, do të lëshojë një dokument të ri udhëtimi me të njëjtën periudhë vlefshmërie.

Neni 5

Ripranimi i shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi

1. Islanda do të ripranojë, me kërkesë të Republikës së Shqipërisë dhe pa formalitete të mëtejshme, veç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi, të cilët nuk plotësojnë, ose nuk i plotësojnë më tej, kushtet në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e Republikës së Shqipërisë, me kusht që të provohet ose të pranohet në mënyrë të vlefshme në bazë të sigurimit të provave të qarta, se këta persona:

- a) kanë ose, në kohën kur kanë hyrë, kanë pasur vizë ose lejeqëndrimi të lëshuar nga Islanda; ose

- b) kanë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, pasi kanë qëndruar në, ose kanë kaluar transit nëpër territorin e Islandës.

2. Detyrimi për ripranim në paragrafin 1 nuk do të zbatohet, nëse:

- a) shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi ka kaluar vetëm transit nëpër një aeroport ndërkombëtar të Islandës; ose

- b) Republika e Shqipërisë i ka dhënë shtetasit të vendit të tretë ose personit pa shtetësi një vizë ose lejeqëndrimi para ose pas hyrjes në territorin e saj, përveç rastit kur:

- ai person zotëron një vizë ose lejeqëndrimi të lëshuar nga Islanda, që ka një periudhë vlefshmërie më të gjatë; ose

- viza ose leja e qëndrimit e lëshuar nga Republika e Shqipërisë është marrë duke përdorur dokumente të rreme apo të falsifikuara; ose
 - personi nuk plotëson kushtet që i bashkëlidhen vizës.
3. Pasi Islanda ka dhënë një përgjigje pozitive për aplikimin e ripranimit Republika e Shqipërisë do ta pajisë personin, për ripranimin e të cilit është rënë dakord, me dokumente udhëtimi të njohura nga Islanda.

PJESA III PROCEDURA E RIPRANIMIT

Neni 6 **Parimet**

1. Sipas paragrafit 2, çdo transferim i një personi që do të ripranohet mbi bazën e njërit prej detyrimeve që përmbajnë nenet 2 deri 5 kërkon paraqitjen e një kërkesë për ripranim tek autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar.

2. Kërkesa për ripranim mund të zëvendësohet me një komunikim me shkrim pranë autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar brenda një periudhe kohe të arsyeshme përpara kthimit të personit në fjalë, me kusht që personi që do të ripranohet zotëron një dokument udhëtimi të vlefshëm dhe, aty ku është e zbatueshme, një vizë ose lejeqëndrimi të vlefshme të shtetit të kërkuar.

Neni 7

Kërkesa për ripranim

1. Për aq sa është e mundur, kërkesa për ripranim duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:
a) të dhënat personale të personit që do të ripranohet (p.sh. emri, mbiemri, data e lindjes, dhe, aty ku është e mundur, vendi i lindjes, emri i babait, emri i nënës dhe vendbanimi i fundit);

b) përshkrim të mënyrave me anë të të cilave do të sigurohen provat e qarta për shtetësinë, transitin, kushtet për ripranimin e shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi, si dhe hyrjen dhe qëndrimin e paligjshëm.

2. Për aq sa është e mundur, kërkesa për ripranim duhet të përmbajë gjithashtu informacionin e mëposhtëm:

a) një deklaratë ku tregohet që personi që do të transferohet mund të ketë nevojë për ndihmë apo kujdes, me kusht që personi në fjalë ta ketë shprehur pranimin e tij për këtë deklaratë;

b) çdo masë tjetër mbrojtjeje apo sigurie, e cila mund të jetë e nevojshme për rastin e veçantë të transferimit.

3. Një formular i përbashkët, që do të përdoret për kërkesat për ripranim, është bashkëngjitur si aneksi 5 i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

Mjetet e provës në lidhje me shtetësinë

1. Prova për shtetësinë, sipas neneve 2 (1) dhe 4 (1), mund të jepet veçanërisht nëpërmjet çdonjërit prej dokumenteve të renditura në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje, edhe nëse periudha e vlefshmërisë së tyre ka mbaruar. Nëse paraqiten dokumente të tilla, Republika e Shqipërisë dhe Islanda do ta njohin reciprokisht shtetësinë pa qenë nevoja për hetim të mëtejshëm. Prova për shtetësinë nuk mund të jepet nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara.

2. Provat *prima facie* (e qarta) për shtetësinë, sipas neneve 2 (1) dhe 4 (1), mund të jepet veçanërisht nëpërmjet dokumenteve të renditura në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje, edhe nëse periudha e vlefshmërisë së tyre ka mbaruar. Nëse paraqiten dokumente të tilla, Republika e Shqipërisë dhe Islanda do të pranojë përcaktimin e shtetësisë me përjashtim të rastit kur ato mund të vërtetojnë të kundërtën. Provat e qarta në lidhje me shtetësinë nuk mund të jepen nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara.

3. Nëse nuk mund të paraqitet asnjë nga dokumentet e renditura në aneksin 1 ose në aneksin 2, përfaqësitë kompetente diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë ose Islandës do të marrin masat, me paraqitjen e një kërkesë, për të intervistuar pa vonesë personin që do të ripranohet me qëllim që të përcaktojë shtetësinë e tij/saj.

Neni 9

Mjetet e provës në lidhje me shtetasit e vendeve të treta dhe personat pa shtetësi

1. Prova e kushteve për ripranimin e shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi, përcaktuar në nenin 3 (1) dhe nenin 5 (1), do të jepet veçanërisht nëpërmjet njërit prej mjeteve të provës të renditura në aneksin 3 të kësaj Marrëveshjeje; ajo nuk mund të jepet nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara. Çdo provë e tillë njihet reciprokisht nga Republika e Shqipërisë dhe Islanda pa qenë nevoja për hetim të mëtejshëm.

2. Prova e qartë për kushtet e ripranimit të shtetasve të vendeve të treta dhe të personave pa shtetësi, përcaktuar në nenet 3 (1) dhe 5 (1), do të jepet veçanërisht nëpërmjet njërit prej mjeteve të provës të shënuara në aneksin 4 të kësaj Marrëveshjeje; ato nuk mund të jepen nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara. Kur paraqiten të tilla prova *prima facie* (të qarta), Republika e Shqipërisë dhe Islanda vlerësojnë përcaktimin e kushteve, përveç rastit kur mund të vërtetojnë të kundërtën.

3. Paligjshmëria e hyrjes, qëndrimit apo banimit do të përcaktohet me anën e dokumenteve të udhëtimit të personit në fjalë në të cilat mungojnë viza e nevojshme ose leja e qëndrimit e nevojshme në territorin e shtetit kërkues. Një deklaratë e shtetit kërkues që personi në fjalë është gjetur pa dokumentet e nevojshme të udhëtimit, vizë apo lejeqëndrimi paraqitet si provë e qartë për hyrjen, qëndrimin ose banimin e paligjshëm.

Neni 10

Afatet kohore

1. Kërkesa për ripranim duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar brenda një periudhe maksimale 180 ditore nga koha kur autoriteti kompetent i shtetit kërkues merr dijeni që një shtetas i një vendi të tretë apo një person pa shtetësi nuk plotëson, ose nuk i plotëson më tej, kushtet që janë në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin. Kur ka pengesa ligjore ose faktike që kërkesa të paraqitet në kohë, afati kohor, me kërkesë të shtetit kërkues, do të shtyhet, por vetëm derisa pengesa të mos ekzistojë më.

2. Një kërkesë për ripranim duhet t'i kthehet përgjigje pa vonesë të panevojshme, dhe në çdo rast brenda një periudhe maksimale prej 25 ditësh kalendarike; për mospranimin e një kërkesë për ripranim do të jepen arsyet. Afati kohor fillon nga data e marrjes së kërkesës për ripranim. Nëse brenda këtij afati kohor nuk ka përgjigje, do të konsiderohet se është rënë dakord për transferimin e personit.

3. Kur ka pengesa ligjore dhe faktike për kërkesën që i përgjigjesh brenda 25 ditëve kalendarike, kjo periudhë kohore mund, pas një kërkesë të motivuar, të shtyhet deri në një maksimum prej 60 ditësh kalendarike. Nëse nuk kthehet përgjigje pas kohës shtesë, transferimi do të quhet i aprovuar.

4. Pasi është pranuar kërkesa, apo kur është e nevojshme, pas mbarimit të periudhës së cituar në paragrafin 2, personi në fjalë transferohet pa vonesë dhe, e shumta, brenda tre muajve. Mbi bazën e kërkesës së shtetit kërkues, ky afat kohor mund të zgjatet sa koha që duhet për të kaluar pengesat ligjore apo praktike.

Neni 11

Modalitetet e transferimit dhe mënyrat e transportimit

1. Para kthimit të një personi, autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë dhe Islandës do të bien në ujdë që më parë me shkrim në lidhje me datën e transferimit, vendin e hyrjes, shoqërimin e mundshëm dhe të dhëna të tjera që kanë lidhje me transferimin.

2. Nuk do të ndalohet asnjë mjet transporti, qoftë nga ajri, toka apo deti. Kthimi në rrugë ajrore nuk do të kufizohet në përdorimin e shoqërive të transportit të Republikës së Shqipërisë ose Islandës dhe mund të kryhet duke përdorur avionë linje apo çarter. Në rastin e kthimeve të shoqëruara, këta shoqërues nuk kufizohen vetëm në persona të autorizuar të shtetit kërkues, me kusht që të jenë persona të autorizuar nga Republika e Shqipërisë ose Islanda.

Neni 12

Ripranimi i gabuar

Republika e Shqipërisë do të marrë mbrapsht pa vonesë çdo person të ripranuar nga Islanda, dhe Islanda do të marrë mbrapsht pa vonesë çdo person të ripranuar nga Republika e Shqipërisë, nëse vërtetohet, brenda një periudhe tremujore pas transferimit të personit në fjalë, që nuk ishin plotësuar kërkesat e vendosura në nenet 2 dhe 5 të kësaj Marrëveshjeje.

Në këto raste, autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe Islandës do të shkëmbejnë gjithashtu të gjithë informacionin e disponueshëm që ka të bëjë me identitetin aktual, shtetësinë ose

itinerarin e transitit të personit që do të merret mbrapsht.

PJESA IV OPERACIONET TRANSIT

Neni 13

Parimet

1. Republika e Shqipërisë dhe Islanda duhet të kufizojnë transitin e shtetasve të vendeve të treta apo të personave pa shtetësi, në raste kur këta persona nuk mund të kthehen direkt në shtetin e destinacionit.

2. Republika e Shqipërisë do të lejojë kalimin transit të shtetasve të vendeve të treta ose të personave pa shtetësi, nëse Islanda e kërkon një gjë të tillë, dhe Islanda do të autorizojë transitin e shtetasve të vendeve të treta apo të personave pa shtetësi, nëse Republika e Shqipërisë e kërkon një gjë të tillë, nëse sigurohet udhëtimi i mëtejshëm transit në shtete të tjera të mundshme të transitit dhe nëse sigurohet ripranimi nga shteti i destinacionit.

3. Transiti mund të refuzohet nga Republika e Shqipërisë ose Islanda:

a) nëse shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi rrezikon realisht të bëhet subjekt i torturës ose i trajtimit, apo ndëshkimit çnjerëzor apo poshtërues, i dënimit me vdekje ose i përndjekjes për shkak të racës, fesë, kombësisë, pjesëmarrjes në një grup shoqëror apo një bindjeje politike të veçantë, në shtetin për ku është drejtuar apo në një shtet tjetër ku do të kalojë transitit; ose

b) nëse shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi do t'i nënshtrohet ndjekjes ose sanksioneve penale në shtetin e kërkuar ose në një shtet tjetër të transitit; ose

c) për arsye të shëndetit publik, sigurisë së brendshme, rendit publik ose interesave të tjera të shtetit të kërkuar.

4. Republika e Shqipërisë ose Islanda mund të anulojnë çdo leje të dhënë nëse më vonë lindin ose dalin në dritë rrethanat e përmendura në paragrafin 3, të cilat bëhen pengesë për operacionet e transitit ose nëse udhëtimi i mëtejshëm në shtete të mundshme të transitit ose ripranimi nga ana e shtetit të destinacionit nuk sigurohen më. Në këtë rast shteti kërkuar e merr sërish shtetasin e vendit të tretë ose personin pa shtetësi, sipas nevojës dhe pa vonesë.

Neni 14

Procedura transitit

1. Një kërkesë për operacionet e transitit duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar me shkrim dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) llojin e transitit (me rrugë ajrore, tokësore apo detare), shtetet e tjera të mundshme për transit dhe destinacioni përfundimtar;

b) të dhënat e veçanta të personit në fjalë (p.sh. emri, mbiemri, emri i vajzërisë, emra të tjera që përdor ose pseudonime, data e lindjes, seksi dhe, aty ku është e mundur, vendi i lindjes, kombësia, gjuha, lloji dhe numri i dokumentacionit të udhëtimit);

c) vendi i parashikuar i hyrjes, koha e transferimit dhe përdorimi i mundshëm i shoqëruesve;

d) një deklaratë që sipas mendimit të shtetit kërkuar përmbushen kushtet sipas nenit 13 (2) dhe që nuk ka arsye për mospranim sipas nenit 13 (3).

Një formular i përbashkët për t'u përdorur për kërkesat për transit është bashkëngjitur si aneksi 6 i kësaj Marrëveshjeje.

2. Shteti i kërkuar do ta njoftojë, brenda pesë ditëve kalendarike dhe me shkrim, shtetin kërkuar për pranimin, duke konfirmuar vendin e hyrjes dhe kohën e parashikuar të pranimi, ose do ta njoftojë atë për mospranimin e kërkesës dhe për arsyet e këtij mospranimi.

3. Nëse operacionet e transitit kryhen në rrugë ajrore, personi që do të ripranohet dhe shoqëruesit e mundshëm shmangen nga detyrimi për të marrë vizë transiti aeroportuale.

4. Autoritetet kompetente të shtetit të kërkuar, pas konsultimeve reciproke, do të ndihmojnë në operacionet e transitit, në veçanti nëpërmjet mbikëqyrjes së personave në fjalë dhe dhënies së mjeteve të përshtatshme për këtë qëllim.

PJESA V KOSTOT

Neni 15

Kostot e transportit dhe transitit

Pa cenuar të drejtën e autoriteteve kompetente për të rimbursuar kostot, lidhur me ripranimin, të shkaktuar nga ana e personit që do të ripranohet apo nga palë të treta, të gjitha kostot e transportit, në lidhje me ripranimin dhe operacionet e transitit në përputhje me këtë Marrëveshje deri në kufirin e shtetit të destinacionit përfundimtar do të përballohen nga ana e shtetit kërkuar.

PJESA VI

MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE KLAUZOLA E MOSNDIKIMIT

Neni 16

Mbrojtja e të dhënave

Komunikimi i të dhënave personale do të bëhet vetëm nëse është i nevojshëm për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë ose Islandës sipas rastit.

Komunikimi, përpunimi dhe trajtimi i të dhënave personale në ndonjë rast të veçantë, autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë do t'u nënshtrohen ligjeve të brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe autoritetet kompetente të Islandës do t'u nënshtrohen ligjeve të brendshme të Islandës. Gjithashtu do të zbatohen edhe parimet e mëposhtme:

- a) të dhënat personale duhet të transmetohen në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;
- b) të dhënat personale duhet të mblidhen për qëllim specifik, të qartë dhe të ligjshëm për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe nuk duhet të përpunohen më tej qoftë nga autoriteti dërgues, qoftë nga autoriteti marrës në një mënyrë që nuk përputhet me atë qëllim;
- c) të dhënat personale duhet të jenë të përshtatshme, përkatëse dhe të mos e tejkalojnë qëllimin për të cilin janë mbledhur dhe/ose komunikuar; në veçanti, të dhënat personale që komunikohen mund të kenë të bëjnë vetëm me sa vijon:
 - të dhënat e veçanta të personit që do të transferohet (p.sh. emri, mbiemri, emra të mëparshëm, emra të tjerë të përdorur ose pseudonime, seksi, gjendja civile, data dhe vendi i lindjes, kombësia aktuale dhe e mëparshme);
 - pasaportën, kartën e identitetit ose dëshmia e aftësisë për drejtim mjeti (numri, periudha e vlefshmërisë, data e lëshimit, autoriteti që e ka lëshuar, vendi ku është lëshuar);
 - ndalesat dhe itineraret;
 - informacione të tjera të nevojshme për të identifikuar personin që do të transferohet ose për të shqyrtuar kërkesat e ripranimit në përputhje me këtë Marrëveshje;
- d) të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe, aty ku është e mundur, të përditësuara;
- e) të dhënat personale duhet të ruhen në një formë që lejon identifikimin e subjektit të të dhënave, por jo më shumë se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin këto të dhëna janë mbledhur ose për të cilin ato përpunohen më tej;
- f) autoriteti komunikues dhe autoriteti marrës i të dhënave do të ndërmarrin çdo hap të arsyeshëm për të bërë saktësimin, eliminimin ose bllokimin e duhur të të dhënave personale në rastin kur komunikimi i tyre nuk përputhet me dispozitat e këtij neni, në mënyrë të veçantë nëse ato të dhëna nuk janë të përshtatshme, nuk janë përkatëse, janë të pasakta ose e tejkalojnë qëllimin për të cilin janë komunikuar. Kjo përfshin njoftimin e çdo korrigjimi, zhdukjeje apo bllokimi nga pala tjetër;
- g) mbi bazën e kërkesës, autoriteti marrës i të dhënave do ta informojë autoritetin dërgues, mbi përdorimin e të dhënave të komunikuar dhe për rezultatet e përfuara prej tyre;
- h) të dhënat personale mund t'u komunikohen vetëm autoriteteve kompetente. Komunikimi i mëtejshëm për organizma të tjerë kërkon miratimin paraprak të autoritetit dërgues.
- i) autoriteti dërgues dhe autoriteti marrës i të dhënave janë të detyruara të mbajnë procesverbal me shkrim për komunikimin dhe marrjen e të dhënave personale.

Neni 17

Dispozita e mosndikimit

1. Kjo Marrëveshje nuk do të cenojë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Republikës së Shqipërisë dhe Islandës që burojnë nga e drejta ndërkombëtare, dhe veçanërisht nga:

- Konventa e 28 korrikut 1951 mbi statusin e refugjatëve siç është ndryshuar nga protokolli i 31 janarit 1967 mbi statusin e refugjatëve.

- Konventat ndërkombëtare, që përcaktojnë shtetin përgjegjës për shqyrtimin e aplikimeve për azil.

- Konventa Europiane e 4 nëntorit 1950 për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

- Konventa kundër torturës ose trajtimit mizor, çnjerëzor dhe degradues dhe ndëshkimit e 10 dhjetorit 1984;

- Konventat ndërkombëtare mbi ekstradimin dhe kalimin transit;

- Konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare shumëpalëshe për ripranimin e shtetasve të huaj.

2. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk ndalon kthimin e një personi sipas marrëveshjeve të tjera formale apo informale.

PJESA VII REALIZIMI DHE ZBATIMI

Neni 18

Grupi i përbashkët i ekspertëve

1. Shqipëria dhe Islanda do t'i japin njëra-tjetrës asistencë të ndërsjellë në zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim ato do të krijojnë një grup të përbashkët ekspertësh (në vijim i quajtur "komiteti"), i cili do të ketë, në veçanti, detyrën:

a) të vëzhgojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

b) të propozojë ndryshime në këtë Marrëveshje dhe në anekset e saj.

2. Vendimet e komitetit do të jenë detyruese për palët.

3. Komiteti do të mbledhet sa herë që është e nevojshme dhe me kërkesën e njëres prej palëve.

4. Komiteti do të miratojë normat e tij procedurale.

Neni 19

Protokollet zbatuese

1. Me kërkesë të njëres prej palëve, do të hartohet një protokoll zbatimi që do të mbulojë rregullat mbi:

a) përcaktimin e autoriteteve kompetente, pikat e kalimit kufitar dhe shkëmbimin e pikave të kontaktit;

b) kushtet për kthimet e shoqëruara, përfshirë transitin e shoqëruar të shtetasve të vendeve të treta dhe të personave pa shtetësi nën shoqërim;

c) mjetet dhe dokumentet shtesë, veç atyre të renditura në anekset 1 deri 4 të kësaj marrëveshjeje.

2. Protokollet zbatuese, referuar në paragrafin 1, do të hyjnë në fuqi vetëm pasi të njoftohet komiteti i ripranimit, referuar në nenin 18.

PJESA VIII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 20

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të ratifikohet apo miratohet nga palët në përputhje me procedurat e tyre përkatëse.

3. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës në të cilën Palët njoftojnë njëra-tjetrën që janë përfunduar procedurat e përcaktuara në paragrafin e parë. Nëse kjo datë është para datës së hyrjes në fuqi të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Islandës për lehtësimin e vizave, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në të njëjtën kohë.

4. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar.

5. Palët mund ta denoncojnë këtë Marrëveshje duke njoftuar zyrtarisht palën tjetër kontraktuese.

Kjo Marrëveshje do të pushojë së vepruari gjashtë muaj pas datës së këtij njoftimi.

Neni 21

Anekset

Anekset nga 1 deri në 6 formojnë pjesët integrale të kësaj Marrëveshjeje
Bërë në Tiranë, më 26 gusht 2008, në dy kopje në gjuhën shqip, islandisht dhe anglisht, duke qenë secili prej këtyre teksteve njëloj i barasvlefshëm. Në rast keqinterpretimesh, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

ANEKSI 1

LISTA E PËRBASHKËT E DOKUMENTEVE, PARAQITJA E TË CILAVE KONSIDEROHET SI DËSHMI E QARTË PËR SHTETËSINË (Nenet 2 (1), 3 (1), 4 (1) dhe 5 (1))

- Pasaporta të çdo lloji (pasaporta kombëtare, pasaporta diplomatike, pasaporta shërbimi, pasaporta kolektive dhe pasaporta zëvendësuese përfshirë pasaportat e fëmijëve);
- kartat e identitetit të çdo lloji (përfshi edhe kartat e përkohshme dhe kartat provizore);
- librezat ushtarake dhe kartat e identitetit ushtarake;
- librezat marinarësh dhe karta shërbimi të kapitenëve të anijeve;
- certifikata shtetësie dhe dokumente të tjera zyrtare që përmendin apo tregojnë shtetësinë.

ANEKSI 2

LISTA E PËRBASHKËT E DOKUMENTEVE, PARAQITJA E TË CILAVE KONSIDEROHET SI PROVË E QARTË PËR SHTETËSINË (Nenet 2 (1), 3 (1), 4 (1) dhe 5 (1))

- Fotokopje e secilit nga dokumentet e shënuara në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje;
- Patenta ose fotokopje të tyre;
- Certifikatat e lindjes ose fotokopjet e tyre;
- Kartat e identitetit të kompanive ose fotokopje të tyre;
- Dëshmi nga dëshmitarë;
- Dëshmi të bëra nga personi në fjalë dhe gjuha e folur prej tij/saj, përfshi edhe përfundimet e një provimi zyrtar;
- Çdo dokument tjetër që mund të ndihmojë për të përcaktuar shtetësinë e personit në fjalë.

ANEKSI 3

LISTA E PËRBASHKËT E DOKUMENTEVE, TË CILAT KONSIDEROHEN SI PROVË E KUSHTEVE PËR RIPRANIMIN E SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI (Nenet 3 (1) dhe 5 (1))

- Viza e vlefshme dhe/ose autorizime banimi lëshuar nga shteti i kërkuar;
- vulat e hyrjes/daljes ose shënime të ngjashme në dokumentin e udhëtimit të personit në fjalë ose prova të tjera të hyrjes/daljes (p.sh. prova fotografike).

ANEKSI 4

LISTA E PËRBASHKËT E DOKUMENTEVE QË KONSIDEROHEN SI PROVA TË QARTA PËR KUSHTET PËR RIPRANIMIN E SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI (Nenet 3 (1) dhe 5 (1))

- Dokumente, certifikata dhe fatura të çdo lloji (p.sh. fatura hoteli, konfirmime për trajtim mjekësor ose spitalor, dokumente hyrjeje për në institucione publike/private, marrëveshje për marrje makinash me

qira, fatura të kartave të kreditit etj.), që tregojnë qartë që personi në fjalë ka qëndruar në territorin e shtetit të kërkuar;

- bileta dhe/ose lista pasagjerësh të udhëtimeve me avion, tren, autobus apo anije, të cilat tregojnë praninë dhe itinerarin e personit në fjalë në territorin e shtetit të kërkuar;

- informacion që tregon se personi në fjalë ka përdorur shërbimet e një agjencie transporti apo udhëtimesh;

- dëshmi zyrtare të lëshuara, në veçanti, nga pjesëtarët e personelit të autoriteteve kufitare dhe dëshmitarë të tjerë që mund të dëshmojnë për kalimin e kufirit nga ana e personit në fjalë;

- dëshmi zyrtare të bëra nga personi në fjalë në procedura gjyqësore apo administrative;

- përshkrim i vendit dhe rrethanave nën të cilat personi në fjalë është kapur pas hyrjes në territorin e shtetit kërkuar, lëshuar nga autoritetet përkatëse të atij shteti;

- informacion lidhur me identitetin dhe/ose qëndrimin e një personi, lëshuar nga një organizatë ndërkombëtare;

- njoftim/konfirmim i informacionit nga pjesëtarët e familjes, shoqëruesit në udhëtim etj.;

- dëshmi nga personi në fjalë.

ANEKSI 5

.....

.....

(vendi dhe data)

.....
(Përcaktimi i autoritetit kompetent
të shtetit kërkuar)

Referenca:

☐ PROCEDURË E PËRSHPEJTUAR

Për

.....

.....

.....

(Përcaktimi i autoritetit kompetent
të shtetit të kërkuar)

KËRKESË PËR RIPRANIM

Sipas nenit 7 të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Islandës për ripranimin

A. TË DHËNA PERSONALE

1. Emri i plotë (mbiemri i nënvizuar)

.....

Fotografia

2. Emri i vajzërisë:

.....

3. Data dhe vendi i lindjes:

.....

4. Seksi dhe përshkrimi fizik (lartësia, ngjyra e syve, shenja të veçanta etj.):

.....

5. I njohur gjithashtu si (emra të mëparshëm, emra të tjerë të përdorur ose pseudonime):

.....

6. Shtetësia dhe gjuha:

.....

7. Gjendja civile: ☐ i martuar ☐ beqar ☐ i divorcuar ☐ i ve

Nëse është i martuar: emri i bashkëshortit/bashkëshortes.....

Emrat dhe mosha e fëmijëve (nëse ka).....

.....

.....

.....

Adresa e fundit në shtetin kërkues:

.....

Vendi i fundit i banimit në shtetin e kërkuar

B. RRETHANA TË VEÇANTA NË LIDHJE ME TË TRANSFERUARIN

1. Gjendja shëndetësore

(p.sh. sqarime të mundshme për trajtim të veçantë mjekësor, emri latinisht i sëmundjes ngjitëse):

.....

2. Shënime treguese për person shumë të rrezikshëm:

(p.sh. i dyshuar për vepra të rënda penale, sjellje agresive):

.....

C. MJETET E PROVËS TË BASHKËNGJITURA

.....

(Nr. i pasaportës)

.....

(Autoriteti lëshues)

.....

(Nr i kartës së identitetit)

.....

(Autoriteti lëshues)

.....

(Nr. i patentës)

.....

(autoriteti lëshues)

.....

(Nr. i dokumenteve të tjera zyrtare)

.....

(Autoriteti lëshues)

.....

(data dhe vendi i lëshimit)

.....

(data e skadimit)

.....

(data dhe vendi i lëshimit)

.....

(data e skadimit)

.....

(data dhe vendi i lëshimit)

.....

(data e skadimit)

.....

(data dhe vendi i lëshimit)

.....

(data e skadimit)

D. VËREJTJE/SHËNIME

.....

.....

.....

.....

Firma e autoritetit kompetent të shtetit kërkues (vula)

.....
(Përcaktimi i autoritetit kompetent
të shtetit kërkues)

.....
(vendi dhe data)

Referenca:
Për

.....
.....
.....
(Përcaktimi i autoritetit kompetent
të shtetit të kërkuar)

KËRKESË PËR TRANSIT

Sipas nenit 14 të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Islandës për ripranimin e personave që qëndrojnë pa autorizim.

A. TË DHËNA PERSONALE

1. Emri i plotë (mbiemri i nënvizuar)
.....

Fotografia

2. Emri i vajzërisë:
.....

3. Data dhe vendi i lindjes:
.....

4. Seksi dhe përshkrimi fizik (lartësia, ngjyra e syve, shenja të veçanta etj.):
.....

5. I njohur gjithashtu si (emra të mëparshëm, emra të tjerë të përdorur ose pseudonime):
.....

7. Shtetësia dhe gjuha:
.....

Tipi dhe numri i dokumentit të udhëtimit:
.....

RRETHANAT E VEÇANTA PËR TRANSFERIMIN

Gjendja shëndetësore
(P.sh. sqarime të mundshme për trajtim të veçantë mjekësor, emri në latinisht i sëmundjes ngjitëse):
.....

Shënime treguese për person shumë të rrezikshëm:
(p.sh. i dyshuar për vepra të rënda penale, sjellje agresive)

OPERACIONI TRANSIT

Lloji i transitit

☐ në rrugë ajrore ☐ në rrugë detare ☐ në rrugë tokësore

2. Shteti i destinacionit përfundimtar

.....

Shtete të tjera të mundshme të transitit

.....

Pika e propozuar e kalimit të kufirit, data, koha e transferimit dhe shoqërimet e mundshme

.....

.....

.....

Pranimi i garantuar në çdo shtet tjetër transiti dhe në shtetin e destinacionit përfundimtar (neni 13, paragrafi 20)

☐ po

☐ jo

Të dhëna për arsyet për mospranimin e transitit
(neni 13, paragrafi 3)

☐ po

☐ jo

C. VËREJTJE

.....

.....

.....

.....

(Firma e autoritetit kërkues) (Vula)

UDHËZIM

Nr.26/1, datë 20.11.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.26, DATË 4.9.2008 “PËR TAKSAT KOMBËTARE”

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1203, datë 27.8.2008 “Për përcaktimin e vlerës së saktë, në përqindje, të rentës së pasurisë minerare, sipas vlerës së tregut, për çdo mineral apo grup mineralesh”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”, pika 2.4 ndryshon si më poshtë:

2.4 Taksa e rentës minerare

2.4.1 Taksa e rentës minerare përcaktohet në pikën 4 të nenit 4 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave, në zbatim të tij.

Vlera e saktë, në përqindje, e rentës së pasurisë minerare, sipas vlerës së tregut, për çdo mineral apo grup mineralesh, sipas emërtimeve të shtojcës nr.2 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit, 15-ditëshin e parë të muajit shkurt të çdo viti.

Subjektet, zotëruese të lejes së shfrytëzimit të mineraleve, brenda datës 15 të muajit pasardhës, duhet të derdhin për llogari të degës së tatimeve ku ushtrojnë aktivitetin, taksën e rentës së pasurisë minerare, sipas llojit të mineralit të prodhuar (nxjerrë), sipas specifikimeve të shtojcës nr.2 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 «Për taksat kombëtare», si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave në zbatim të tij.

Kur subjekti eksporton specifikisht mineralet, sipas emërtimeve të shtojcës nr.2 të ligjit “Për taksat kombëtare” apo nënprodukte minerare (koncentrat minerali dhe produkte metalurgjike), renta minerare do të aplikohet në doganë, në momentin kur bëhet deklarata e eksportit.

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dërgon në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave listën me normativat korresponduese të mineraleve të përdorura për prodhimin e nënprodukteve minerare.

Lista e normativave korresponduese të mineraleve të përdorura për prodhimin e nënprodukteve, duhet të publikohet edhe në *website*-n e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Për të gjitha nënproduktet minerare, për të cilat ka normativa të përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, organet doganore dhe tatimore do t'u referohen këtyre normativave, për përcaktimin e vlerës mbi të cilën do të llogaritet renta minerare.

a) Nëse mineralet apo nënproduktet e tyre (koncentrat minerali apo prodhime metalurgjike) destinohen për konsum final në tregun e brendshëm, renta minerare paguhet për llogari të degëve tatimore nga subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit të mineralit. Baza e taksueshme, mbi të cilën aplikohet renta minerare, është vlera e deklaruar në faturën e shitjes së mineralit nga shitësi për mineralet dhe vlera e prodhimit (nxjerrjes) të mineralit të përdorur për prodhimin e nënprodukteve, sipas normativave korresponduese për nënproduktet (për ato nënprodukte që ka normativa të përcaktuara, sipas shembullit 1 më poshtë).

b) Kur subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit është edhe eksportues minerali apo nënprodukti të tij (koncentrat minerali dhe prodhime metalurgjike), renta minerare për sasinë e eksportuar paguhet në degët doganore në momentin e bërjes së deklaratës doganore të eksportit. Pagesa e kësaj takse, në rastin e eksportit, evidentohet me mandatar këtëimi ose në deklaratën doganore të eksportit. Baza e taksueshme, mbi të cilën do të aplikohet renta minerare, është si më poshtë:

- për eksportin e mineraleve të specifikuar në shtojcën nr.2 të ligjit, vlera e faturës së shitjes së mineraleve.

- për eksportin e nënprodukteve (koncentrat minerali dhe prodhime metalurgjike) për të cilat ka normativa korresponduese, vlera e kostonë së prodhimit (nxjerrjes) së mineralit të përdorur për këto nënprodukte. Kjo vlerë përcaktohet bazuar në sasinë e produktit përfundimtar (koncentrat apo prodhime metalurgjike), të deklaruar në doganë, si dhe normativat dhe kostot korresponduese të mineralit të përdorur, të dërguara nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, sipas shembullit të mëposhtëm:

Shembull 1. Subjekti X po eksporton një sasi 100 tonë prodhim ferrokromi nga miniera e Bulqizës, mesatarisht 39%, Cr2O3. Supozojmë se normativat korresponduese janë respektivisht, për 1 ton ferrokrom FeCr nevojiten 2,75 tonë mineral Cr2O3 dhe kostoja e 1 ton lënde të parë (minerali) është 75 usd/tonë. Në këtë rast, përkatësisht për sasinë prej 100 tonësh ferrokrom të eksportuar janë përdoruar $(100 \times 2.75) = 275$ tonë mineral $\times 75$ usd/ton = 20.625 USD, pra 20.625 USD është vlera mbi të cilin do të aplikohet përqindja e rentës minerare në doganë, e konvertuar në lekë, me kursin e këmbimit të cilin aplikon dogana ditën e kryerjes së transaksionit.

c) Kur eksporti i mineralit apo nënprodukteve (koncentrat minerali apo prodhime metalurgjike) kryhet nga subjekte të cilat janë vetëm eksportuese dhe jo shfrytëzuese të mineralit (e blejnë mineralin apo nënproduktet nga një subjekt tjetër me faturë tatimore), organet doganore do të aplikojnë rentën minerare në doganë, bazuar në faturat e blerjes së mineralit apo nënproduktit të tij. Në këtë rast, subjekteve eksportuese u rimburohet vlera e rentës minerare të paguar në doganë. Rimbursimi kryhet nga organet tatimore, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga subjekti. Dokumentacioni justifikues që subjekti duhet të depozitojë te degët e tatimeve për të marrë rimbursimin është:

1. Kopje e mandatar këtëimit të lëshuar nga dogana ose kopje e deklaratës doganore të eksportit, ku pasqyrohet vlera e rentës minerare të paguar në doganë (paraqitja vetëm e njërit prej dokumenteve është i mjaftueshëm).

2. Kopje e faturës tatimore të blerjes së mineralit nga subjekti shitës.

3. Kopje e kontratës së shitjes, të lidhur ndërmjet subjektit blerës/eksportues dhe shitësit të mineralit, koncentratit të mineralit apo prodhimeve metalurgjike.

d) Kur subjekti eksporton koncentrat minerali apo prodhime metalurgjike të prodhuara tërësisht ose pjesërisht me mineral importi, renta minerare do të aplikohet në doganë, vetëm për pjesën e mineralit të përdorur për këtë sasi eksporti, mineral i cili është blerë apo prodhuar në vend. Për pjesën e mineralit të importuar, subjekti do të depozitojë pranë degës doganore, kopjen e deklaratës doganore të importit (dy kopje), në të cilat punonjësi i doganës do të pasqyrojë sasinë e mineralit të importit, të mbetur gjendje te subjekti (nëse mbetet sasi gjendjeje) me firmën dhe vulën e doganës. Një kopje e dokumentit mbahet nga dega e doganës dhe një i kthehet subjektit për ta paraqitur në doganë, kur bëhet eksporti i radhës.

2.4.2 Për sektorin hidrokarbur, çmimi i naftës bruto mbi të cilin do të aplikohet renta minerare do të miratohet nga komisioni *ad-hoc*, krijuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005. Ministria e Financave, pas miratimit do të dërgojë për zbatim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Çmimi i naftës bruto i vlerësuar në \$/fuçi, do të llogaritet me formulë të posaçme, dhe do të miratohet nga komisioni i krijuar sipas pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1203, datë 27.8.2008. Ky komision do të përdorë për llogaritjen e çmimit të naftës bruto, të dhënat e nxjerra nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) ku do të merren në konsideratë cilësia e naftës bruto, graviteti i naftës bruto, përmbajtja e squfurit, përmbajtja e ujit, përmbajtja e mbetjeve, përmbajtja e fraksioneve të naftës, si dhe elemente të tjera përbërëse.

2.4.3 Për të gjitha kategoritë e tjera të nënprodukteve minerare, të cilat mund të derivojnë nga mineralet e specifikuar në aneksin nr.1 të ligjit “Për taksat kombëtare” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave në zbatim të saj (siç mund të jenë p.sh. nënproduktet e çimentos, argjilës, naftës etj.) dhe për të cilat nuk ka normativa korresponduese të mineraleve, të përcaktuara nga METE, kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit është njëkohësisht edhe përpunues, renta minerare do të aplikohet mbi vlerën e kostos së prodhimit (nxjerrjes) së mineralit, kosto e cila deklarohet nga prodhuesi dhe paguhet pranë organeve tatimore, sipas procedurave të mëposhtme:

a) Kur produkti është mineral i nxjerrë nga miniera dhe i shitur brenda vendit, vlera që do të merret parasysh për aplikimin e rentës është çmimi i shitjes së produktit.

b) Në rastin kur produkti përfundimtar i shitur është përpunuar më tej, vlera e mineralit është e barabartë me çmimin e shitjes së produktit përfundimtar gjatë muajit kalendarik minus:

- shpenzimet e pasurimit, shkrirjes dhe të rafinimit, që janë kryer mbi mineralin;
- shpenzimet e transportit nga miniera në fabrikën e pasurimit, shkritore ose impiantet e rafinimit të mineralit;

- të gjitha shpenzimet e tjera, të cilat nuk janë zbritur dhe që lidhen me koston e pasurimit, shkrirjes ose rafinimit.

2. Çmimi i shitjes nënkupton:

a) Në qoftë se produkti eksportohet, çmimi i shitjes është F.O.B. Shqipëri.

b) Në qoftë se produkti nuk eksportohet, çmimi i shitjes është i barabartë me çmimin e shitjes brenda vendit minus:

- shpenzimet e transportit të produktit nga pika e prodhimit deri në pikën e shitjes F.O.B Shqipëri;
- shpenzimet e tjera të shitjes, nëse ka të tilla.

Zotëruesi i lejes dorëzon brenda datës 5 të çdo muaji formularin tip nr.5, bashkëngjitur këtij udhëzimi. Ai duhet të japë gjithashtu, kur është e nevojshme, edhe të dhënat e mëposhtme:

a) emrin dhe përshkrimin e mineralit;

b) emrin dhe adresën e zotëruesit të lejes dhe administratorit;

c) sasinë e mineralit të prodhuar gjatë muajit të kaluar;

d) një konfirmim lidhur me prodhimin e muajit të kaluar dhe shpërndarjen e tij (p.sh. te konsumatorët, fabrikat e pasurimit, shkritoret, rafineritë ose të depozituar);

e) sasinë e mineralit të shitur te konsumatorët gjatë muajit kalendarik, emrat dhe adresat e blerësve dhe kontratat e shitjes, të cilat duhet të përmbajnë veçoritë mbi natyrën, cilësinë dhe përmbajtjen e mineraleve;

f) emrat dhe vendndodhjet e fabrikave të pasurimit, shkritoreve dhe rafinerive ku është shpërndarë minerali;

g) koston për ton të fabrikës së pasurimit, shkritoreve dhe rafinerive ku është shpërndarë minerali gjatë muajit kalendarik;

h) koston për ton të transportit të mineralit të shitur gjatë muajit kalendarik e detajuar kjo në rastin kur transporti i mineralit kryhet duke kaluar në disa hallka transporti;

i) shpenzimet e shitjes nëse ka dhe që janë kryer gjatë muajit kalendarik;

j) një llogaritje të detajuar të rentës së pasurisë minerare gjatë muajit kalendarik.

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit duhet të mbajë pranë minierës librat përkatës të prodhimit të mineralit nga zona e lejuar dhe të gjithë dokumentacionin që lidhet me to. Të gjitha të dhënat mbi prodhimin, transportin, përpunimin dhe shitjen, përfshirë këtu dhe kontratat e shitjes, kontrollohen nga degët e tatimeve dhe doganave.

Pagesa e rentës minerare do të kryhet nga subjektet e pajisura me leje shfrytëzimi minerale, pranë organeve tatimore.

2.4.4 Kur organet doganore apo tatimore konstatojnë shmangie të dukshme të vlerës së mineralit

apo nënproduktit mineralar të deklaruar nga subjekti me vlerën e tregut, ato do t'u referohen vlerës së tregut për llogaritjen e rentës minerare.

Vlera e tregut për këtë kategori mineralesh apo nënproduktesh, sipas përcaktimit të pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1203, datë 27.8.2008, do të nxirret nga një komision i përbërë nga specialistë të Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore. Vlera e tregut, e përcaktuar nga ky komision, më pas do të dërgohen për miratim pranë komisionit *ad-hoc*, krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005.

Si burim informacioni për krijimin e dosjes me të dhënat e disponueshme për vlerën e eksporteve minerare shërbejnë burime, të tilla: si çmimet e tregjeve ndërkombëtare, të dhënat statistikore të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, investigimi i tregut, brenda dhe jashtë vendit, kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, çmimet e produkteve minerare, të ngjashme, që eksportohen, çmimet e paraqitura në deklaratën e eksportit, për subjektet e tjera, që veprojnë në të njëjtën industri.

Në këto raste, degët doganore dhe tatimore, për llogaritjen e rentës minerare të produkteve minerare apo nënprodukteve, bazuar në vlerat e tregut, do t'u referohen vetëm çmimeve të dërguara nga komisioni *ad-hoc*, krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Formulari nr. 5

AKTRAKORDIMI I TAKSËS SË RENTËS MINERARE PËR MUAJIN _____

Subjekti _____

Lloji i mineralit	Sasia e prodhuar	Sasia e shitur	Subjekti blerës adresa	Taksa e paguar

Administratori
(Emër, mbiemër)

Data _____

UDHËZIM Nr.38, datë 21.11.2008

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET KONSULLORE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME APO TË AMBASADAVE TONA JASHTË VENDIT DHE TARIFA PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE TË UDHËTIMIT

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 e Kushtetutës, të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", Ministri i Financave, Ministri i Punëve të Jashtme dhe Ministri i Brendshëm

UDHËZOJNË:

1. Tarifat për shërbimet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo ambasadave tona jashtë vendit vilen nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe institucionet e tjera në varësi të tyre, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare".

2. Tarifat për pajisjen me pasaportë për dalje jashtë shtetit, vilen nga Ministria e Brendshme apo

drejtoritë/degët në varësi të tyre, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”.

3. Shtetasit që pajisen me pasaportë për dalje jashtë shtetit, përveç pagimit të vlerës së pasaportës, do të paguajnë edhe tarifën e përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të shtojcës nr.1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila është pjesë përbërëse e tij.

4. Për shërbimet që kryhen nga përfaqësitë tona diplomatike në vende të tjera, në bazë të shtojcës nr.1, niveli i tarifës përcaktohet në euro dhe pagimi i tyre mund të bëhet në euro, dollarë ose në monedhen e vendit ku kryhet shërbimi, konvertuar me kursin përkatës ditor të këmbimit.

5. Tarifat e arkëtuara brenda vendit derdhen brenda ditës në llogarinë bankare të thesarit për llogari të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Brendshme. Përfaqësitë tona diplomatike raportojnë çdo muaj në Ministrinë e Punëve të Jashtme mbi tarifën e arkëtuara prej tyre. Ministria e Punëve të Jashtme transferon në fund të muajit në llogarinë bankare të të ardhurave të thesarit shumën totale të tarifave sipas raportimit të bërë nga përfaqësitë tona diplomatike. Çdo muaj Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Brendshme (apo institucionet në varësi të tyre) rakordojnë me degët respektive të thesarit.

Shuma e tarifave të arkëtuara sipas këtij udhëzimi, i takojnë 100% Buxhetit të Shtetit.

6. Me termin “përfaqësi” kuptohet përfaqësia diplomatike apo konsullore e Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Tarifat për veprimet konsullore arkëtohen me fillimin e procedurës përkatëse.

7. Për vjeljen e tarifave konsullore me anën e pullës, Ministria e Punëve të Jashtme planifikon dhe porosit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve pullat konsullore për nevojat e saj dhe të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit.

8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME
Lulzim Basha

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

SHTOJCA NR.1 TARIFAT PËR SHËRBIMET KONSULLORE

I. Tarifat për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit:

- | | |
|--|------------|
| 1. Për lëshimin e pasaportave të udhëtimit | 2000 lekë; |
| 2. Për lëshimin e pasaportave të udhëtimit nga përfaqësitë | 50 euro; |
| 3. Zgjatja e pasaportës nga përfaqësitë | 15 euro; |
| 4. Për lejkalimi | 200 lekë; |
| 5. Lejkalimi lëshuar nga përfaqësitë | 30 euro. |

II. Tarifat për lëshimin, verifikimin dhe legalizimin e dokumenteve:

- | | |
|---|---------------|
| 1. Certifikatë të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit shqiptarë | 30 euro; |
| 2. Certifikatë të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit e huaj | reciprocitet; |

- | | |
|--|---------------|
| 3. Vërtetime të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit shqiptarë | 30 euro; |
| 4. Vërtetime të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit e huaj | reciprocitet; |
| 5. Verifikimi i dokumentit nga përfaqësitë | 10 euro; |
| 6. Legalizimi i dokumentit për shtetasit shqiptarë nga Ministria e Punëve të Jashtme | 200 lekë; |
| 7. Legalizimi i dokumentit nga përfaqësitë për shtetasit shqiptarë | 20 euro; |
| 8. Legalizimi i dokumentit për shtetasit e huaj | reciprocitet. |

III. Tarifatat për lëshimin e përpilimin e akteve të tjera noteriale dhe përkthimin e dokumenteve nga përfaqësitë.

- | | |
|---|---------------|
| 1. Përpilimi i deklaratave, autorizimeve, testamenteve kontratave, garancive dhe prokurave të posaçme nga përfaqësitë | 20 euro/faqe; |
| 2. Vërtetimi i dublikatave dhe kopjeve | 20 euro/faqe; |
| 3. Përkthimi i dokumenteve | 10 euro/faqe. |

Shënim: Me termin “përfaqësi” kuptohet përfaqësia diplomatike ose konsullore jashtë shtetit.

Tarifa mund të arkëtohet edhe në dollarë ose në monedhën e vendit, duke pasur parasysh kursin e këmbimit.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 21.11.2008
Doli nga shtypi më 21.11.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Tiranë, 2008

Çmimi 32 lekë